



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 8.5.2023

Nr: 465

Ora: 12:00

**V E N D I M**

**P Ë R**

**PROPOZIMIN E SANKSIONEVE ADMINISTRATIVE NDAJ DISA DREJTUESVE TË POLICIVE BASHKIAKE, TË CILËT NUK KANË RAPORTUAR NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE LIDHUR ME ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 424, DATË 3.5.2023, TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronjat “dh”, “f”, “n”, dhe 2, dhe nenit 171, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhor”, si dhe vendimit nr. 424, datë 3.5.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për heqjen e materialeve propagandistike që nuk përmbajnë shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...” (vijon emri i subjektit zgjedhor)”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**V Ë R E N:**

Me vendimin nr. 424, datë 3.5.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për heqjen e materialeve propagandistike që nuk përmbajnë shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...” (vijon emri i subjektit zgjedhor)”, është vendosur heqja e të gjitha materialeve propagandistike që nuk përmbajnë shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...” (vijon emri i subjektit zgjedhor).

Për zbatimin e këtij vendimi janë ngarkuar Policët Bashkiake dhe Policia e Shtetit. Drejtuesit e Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit u ngarkuan me detyrimin për të raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve lidhur me zbatimin e këtij vendimi, brenda datës 5.5.2023 deri në orën 24:00.

Data: 8.5.2023 Nr. 465  
Ora: 12:00



“Për propozimin e sanksioneve administrative ndaj disa drejtuesve të policive bashkiake, të cilat nuk kanë raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve lidhur me zbatimin e vendimit nr. 424, datë 3.5.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”

Ky vendim u është njoftuar palëve me shkresën nr. 4641 Prot., datë 4.5.2023. Nga informacioni i administruar rezulton se drejtuesit e Policisë Bashkiake të 57 (pesëdhjetë e shtatë) bashkive nuk kanë raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në kundërshtim me pikën 4, të vendimit nr. 424/ 2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve .

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, e pika 2, nenin 79, pika 1, nenit 171, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimin nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhor”, si dhe vendimin nr. 424, datë 3.5.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për heqjen e materialeve propagandistike që nuk përmbajnë shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...” (vijon emri i subjektit zgjedhor)”,

#### **V E N D O S:**

1. T’i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative gjobë në vlerën 5 000 (pesë mijë) lekë për drejtuesit e Policive Bashkiake, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim do t’u njoftohet Policive Bashkiake, nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 8.5.2023 Nr. 465  
Ora:12:00



“Për propozimin e sanksioneve administrative ndaj disa drejtuesve të policive bashkiake, të cilat nuk kanë raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve lidhur me zbatimin e vendimit nr. 424, datë 3.5.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”

1. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Malësi e Madhe;
2. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Pukë;
3. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Tropojë;
4. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Dibër;
5. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Bulqizë;
6. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Klos;
7. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Mat;
8. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Durrës;
9. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Krujë;
10. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Kamëz;
11. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Vorë;
12. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Kavajë;
13. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Rrogozhinë;
14. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Elbasan;
15. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Belsh;
16. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Peqin;
17. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Gramsh;
18. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Librazhd;
19. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Prrenjas;
20. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Berat;
21. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Poliçan;
22. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Korçë;
23. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Pogradec;
24. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Maliq;
25. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Pustec;
26. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Kolonjë;
27. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Gjirokastër;
28. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Dropull;

Data: 8.5.2023 Nr. 465  
Ora:12:00



“Për propozimin e sanksioneve administrative ndaj disa drejtuesve të policive bashkiake, të cilat nuk kanë raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve lidhur me zbatimin e vendimit nr. 424, datë 3.5.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”

29. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Përmet;
30. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Këlcyrë;
31. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Memaliaj;
32. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Tepelenë;
33. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Selenicë;
34. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Himarë;
35. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Finiq;
36. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Sarandë;
37. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Konispol;
38. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Lezhë;
39. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Mirditë;
40. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Fier;
41. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Lushnjë;
42. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Patos;
43. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Roskovec;
44. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Mallakastër;
45. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Skrapar;
46. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Fushë Arrëz;
47. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Cërrik;
48. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Kukës;
49. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Delvinë;
50. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Has;
51. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Libohovë;
52. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Vlorë;
53. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Kuçovë;
54. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Shkodër;
55. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Vau Dejës;
56. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Devoll;
57. Drejtuesi i Policisë Bashkiake, Bashkia Divjakë.

Data: 8.5.2023 Nr. 465  
Ora:12:00



“Për propozimin e sanksioneve administrative ndaj disa drejtuesve të policive bashkiake, të cilat nuk kanë raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve lidhur me zbatimin e vendimit nr. 424, datë 3.5.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”